



R E P U B L I K A E K O S O V Ë S
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
G J Y K A T A T H E M E L O R E N Ë P R I S H T I N Ë
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA



DEGA NË LIPJAN-OGRAK LIPLJAN

P.nr.785/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Nexhmije Ahmeti, duke vendosur në çështjen penale, ndaj të akuzuarës A. B. nga J. K.L., të cilin e akuzon e PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.8736/14 të dt.14.11.2016, për shkak të veprës penale, Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par. 1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me dt.08.02.2017, në prani të përfaqësuesit të PTH-së, prokurorit Fatmire Cacaj, dhe të akuzuarës, me datë 09.02.2017, merr dhe publikisht shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarës:

A. B., nga i ati M., i lindur me dt. *data e lindjes...* në J., lagjja “Zh.” K. L., me nr. personal *numër personal...*, shqiptarë, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse:

Me datë 05.11.2014, në Qendrën e regjistrimit të automjeteve në Lipjan, e pandehura ka vu në lajthim organin kompetent, për ta vërtetuar një çështje të pavërtetë, e cila ka shërbyer si provë në një çështje, ka prezantuar librezën e qarkullimit të Republikës së Serbisë, me numër CP-08593713, kinse vetura “Opel corsa”, me targa të regjistrimit *numër i targave...*, ka qenë e regjistruar në emër të saj, në Prishtinë, ku pas ekzaminimit laboratorik është konstatuar se e njëjta është tërësisht e falsifikuar dhe mbi këtë bazë, i është lëshuar librezë e qarkullimit, e Republikës së Kosovës, me targa të regjistrimit *numër i targave...*, për veturën “Opel corsa”, me numër të shasisë i njëjtë në të dy librezat W0L000073T4151540, në emër të saj.

-me këtë ka kryer veprën Legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 1, 2, 4, 6, 17, 21, 41, 42, 43, 49, 50, 51, 52, 58, 73, 403 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarën e gjykon:

DENIM ME KUSHT

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse e akuzuara në afat prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër tjetër penale.

DETYROHET e akuzuara që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor t’ia paguaj shumën prej 20 euro, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

DETYROHET e akuzuara A. B. nga J., që të mbaj kontakt me Shërbimin Sprovues të Kosovës, në afat prej 6 muajve pas plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me Aktakuzën e saj PP.II.nr.439/2014 të dt.25.08.2016, e ka akuzuar të pandehurën A. B., për shkak të veprës penale Legalizimi i përmbytjes së rreme nga neni 403 par. 1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar, ka mbetur në tërësi pranë aktit akuzues, dhe është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, e cila është bërë konform dispozitave ligjore dhe në përputhje me provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe në të njëjtën kohë gjykatës i ka propozuar që të pandehurën ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

E pandehura në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe nga gjykata ka kërkuar që t'i shqiptohet një dënim sa më i butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se e akuzuara e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajit mbështet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 248 të KPPK së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të pandehurës, për veprën penale Legalizimi i përmbytjes së rreme nga neni 403 par. 1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për të pandehurën, ashtu që si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi faktin se e njëjta për herë të parë është ndeshur me rregullat pozitive, sjelljen e të pandehurës gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe sjelljen e të njëjtës pas kryerjes së veprës penale, e veçanërisht pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, e në mungesë të rrethanave rënduese, konform nenit 73 të KPRK-së, të njëjtës i shqiptoi dënimin e paraparë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 50 të KPRK-së, e cila dispozitë ka për qëllim që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepër penale.

Konformë nenit 58 të KPRK-së, gjykata e urdhëroi të akuzuaren që të mbaj kontakt me Shërbimin Sprovues të Kosovës, me seli në Prishtinë, nga se në rastin konkret konsideroi se integrimi i të dënuares në shoqëri do të arrihet më mirë përmes mbikqyrjes nga ana e Shërbimit Sprovues.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale bazohet në nenin 450 par. 2, pika 2.6 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN.

P.nr.785/16 dt. 09.02.2017

Sekretarja juridike

Nexhmije Ahmeti

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.